

Akt Themelimi  
i shoqërise me përgjegjësi të kufizuar “**OBELIX**”

Mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë , në Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 , “ Për shoqërítë tregetare” dhe në Ligjin Nr.9723 , datë 03.05.2007 “Për Q.K.R” dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqërítë Tregtare , me vullnetin e tyre të lirë , të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi, sot më datë 25/04/2022 me ortakët :

1. **Darling LLAZARI i pajisur me ID Nr I41207031P**
2. **Pandeli KOKAVESHI i pajisur me ID H90731041V**

krijomë shoqérinë me përgjegjësi të kufizuar “**OBELIX**” me akt themelimi si vijon:

**Neni 1**

Formimi i shoqërisë

Formohet shoqëria tregtare private e quajtur “**OBELIX**”. Shoqëria do ti nënshtrohet legjislacionit shqiptar , ndërsa degët që mund të krijohen do ti nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues .

**Neni 2**

Selia e shoqërisë

- Selia e shoqërisë “**OBELIX**” do te jetë: Himare, Spile, Rruga “2 Dhjetori”, Ndertesa Nr 8, Hyrja Nr 1.
- Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon:  
**sotirlazari@hotmail.com**

Shoqëria mund te ndryshojë selinë e saj , të hapë zyra përfaqësie , degë , te krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë , vetëm me vendim të asamblesë së ortakëve.

**Neni 3**

Objktivi i veprimtarisë

Shoqëria do të zhvillojë veprimtaritë si vijojnë:

- Bar-Restorant

**Neni 4**

Kohëzgjatja e shoqërisë

Kohëzgjatja e shoqërisë do te jetë me një afat 20 (njezet ) vjecar . Ajo mund shpërbehet në cdo kohë dhe përçfarëdo lloj shkaku.

**Neni 5**

Kapitali i shoqërisë

Kapitali fillestari i shoqërisë private “**OBELIX**” do të jetë 100 (njeqind ) Lek dhe është i ndarë në aksione në përputhje me ligjin.

1. Ortaku themelues **Darling LLAZARI**: Zotëruar i një kuote te vetme që përbën 50% te kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortaku themelues **Pandeli KOKAVESHI**: Zotëruar i një kuote te vetme që përbën 50% te kapitalit themeltar të shoqërisë.

**Neni 6**

Drejtimi i shoqërisë

Shoqëria do të drejtohet nga administratori z. **Darling LLAZARI**. Ai është përfaqësuesi i shoqërisë në marrëdhënie me të tretet dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj .

Cdo kontrate do të kryhet prej tij dhe në rast mungese nga një perfaquesues i pajisur me prokurë të posacme .

**Neni 7**

Ortakët themelues kanë të drejte të emërojnë dhe administratorë të tjera të vlerave materiale, kanë të drejtë të caktojnë financierë dhe likuidatorë për problemet e shoqërisë.

**Neni 8**

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqiptar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë .

**Neni 9**

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme , me tekstin rreth saj .

**Neni 10**

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe vecanerisht të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Krijimin e Shoqërise Tregtare” , si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombetare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri .

**Neni 11**

Akti i themelimit u përpilua në 2 kopje , për t'ju shperndare organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë **“OBELIX”**.

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortaku i vetëm .

Ortaku i **“OBELIX”**

**Darling LLAZARI**



Ortaku i **“OBELIX”**

**Pandeli KOKAVESHI**

